



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPAL			
PRANUAR 19 12 23			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-400/03-	60910		

Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nga kryesuesi i KKSBB-së për gjashtëmujorin e dytë

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi funksionon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi. Sipas udhëzimit administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat komunale për Siguri në Bashkësi, neni 9 Detyrat dhe Përgjegjësitë e kryesuesi të KKSBB-së, pika 1.8 është e obliguar të bëhet informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e KKSBB-së.

Duke u bazuar në këtë udhëzim administrativ, ju informoj se në fillim të vitit 2023 me qëllim të realizimit të detyrave operative lidhur me çështjet e Sigurisë në Bashkësi, në mbështetje të nenit 7 të Ligjit nr.04/01-076, për Policinë, nenit 11, pika 2 e udhëzimit administrative nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL, për KKSBB-në, është caktuar orari i punës, ku janë paraparë gjashtë (6) takime të rregullta të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Duke u bazuar në nenin 11, pika 2, ku thuhet “KKSBB-ja mban më së paku gjashtë (6) mbledhje në vit, tri (3) prej se cilave duhet të mbahen në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik dhe tri në gjashtëmujorin e dytë, Komuna e Drenasit i është përmbytur duke mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta gjatë vitit 2023.

Në gjashtëmujorin e dytë për të cilin po informojmë, janë mbajtur tri takime të cilat janë thirrur 7 ditë para mbajtjes së takimit dhe janë publikuar në ueb faqen e komunës së Drenasit. Në këto takime janë diskutuar çështje të cilat lidhen me sigurinë në bashkësi në Komunën e Drenasit, si siguria e ambientit, siguria shëndetësore, siguria rrugore dhe propozime të tjera që kanë dal nga anëtarët e KKSBB-së.

Në mbledhje janë ftuar anëtarët e KKSBB-së dhe monitorues, të cilët janë evidentuar në Listën e Pjesëmarrjes. Në tabelën e mëposhtme të përmbledhur gjeni takimet, temat dhe adresimi i tyre.

Data e Mbledhjes	Temat e diskutuar	Adresimi/Përgjegjësit
03.08.2023 Linku: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/10/Ftesa-dhe-procesverbali-i-KKSB-03.08.2023.pdf	2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 18.05.2023 https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/06/KKSB-Procesverbali.pdf 3. Raport lidhur me zjarret fushore dhe malore nga NJPZSH-ja; 4. Masat e sigurisë për Muajin e Mërgatës; 5. Aksidentet në trafik, raport nga Stacioni Policor në Drenas 6. Të ndryshme	Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/ Drejtoret
26.10.2023 Linku: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/10/Ftesa-per-mbledhjen-KKSB-se-2023.pdf	1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 03.08.2023 https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/10/Ftesa-dhe-procesverbali-i-KKSB-03.08.2023.pdf; 2. Gjendja me zjarre fushore-malore në Komunën e Drenasit; 3. Tetori- Muaji i ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit; 4. Fushata Vetëdijuese në Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore 5. Të ndryshme;	Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/ Drejtoret
30.11.2023 Linku: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/11/FTESA-per-mbledhjen-e-gjashte-te-KKSB-se.pdf	1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 26.10.2023 https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/11/Proces	Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/ Drejtoret

	verbal-i-mbledhjes-se-mbajtur-me-date-26.10.2023-3.pdf 2. Fushatat e organizuara nga KNJKDNJ, ZBGJ nëpër shkolla lidhur me “Trafikimin me qenie njerëzore” dhe përgatitjet për fushatën ”16 Ditë të Aktivizimit Kundër Dhunës në Bazë Gjinore” . 3. Vaksinimi i qenve shtëpiak dhe qenve endacak; 4. Të ndryshme	
--	--	--

- ✓ Përveç KKSB-së janë mbajtur Këshillat Lokal për Sigurinë Publike ashtu siç parashihet me udhëzim administrativ gjithsej 3 takime të kryesuara nga kryesuesi i KLSP-së. Në këto takime janë diskutuar tema që lidhen me sigurinë, me praninë edhe zyrtarëve policor.
- ✓ Në gjashtëmujorin e dytë kemi raportuar në Divizionin për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme për veprimet, masat dhe iniciativat e ndërmarra nga komuna në realizimin/adresimin e sfidave të paraqitura gjatë mbledhjeve për periudhën Janar-Nëntor 2023.
- ✓ Kemi hartuar Planin e Punës dhe Orarin e mbledhjeve për vitin 2024, i cili do të përcillet për miratim në asamblenë komunale pas miratimit në KKSB.



Kryetari i komunës

Ramiz Lladrovci